



**REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT**

KORÇË

VENDIM

Nr 6/ Datë 15/08/2007

PËR

**NDRYSHIMIN E STRUKTURËS NË NDËRMARRJEN E
SHËRBIMEVE PUBLIKE**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës, "PËR NDRYSHIMIN E STRUKTURËS NË NDËRMARRJEN E SHËRBIMEVE PUBLIKE", bazuar në ligjin nr 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "ç", ligjin nr 8379 dt. 09.09.1998 "Për buxhetin lokal", Ligji nr 9645 dt. 27.11.2006 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007", V.K.M nr 551 dt. 07.11.2002, "Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore për efekt page, e për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të Qeverisjes Vendore të ndryshuar", V.K.M nr. 355 dt. 14.06.2006 "Për disa ndryshime në Vendimin nr 551 dt. 07.11.2002 të Këshillit të Ministrave, "Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore për efekt page, e për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të Qeverisjes Vendore të ndryshuar", Udhëzimin nr 2 dt. 17.01.2007 i M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2007", Udhëzimin nr 353 dt.19.03.2007 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2007", V.K.B. nr 3 dt. 02.02.2007 "Për miratimin e strukturës dhe pagave të administratës së Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007", si dhe V.K.B. nr. 2 dt. 02.02.2007 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007", mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë shkrirjen e sektorit të mirëmbajtje banesave.
2. Të mirtojë krijimin e degës teknike. Kjo dege do të jetë e përbërë nga një kryetar dege , një specialist i nivelit të lartë për planifikimin, prokurimet dhe furnizimin, si dhe një specialist i privatizimit të banesave.
3. Të miratojë shtimin e numrit të punonjësve në sektorin e gjelbërimit nga 39 punonjës gjithsej në 40 punonjës duke shtuar një "punëtor gjelbërimit".

4. Të miratojë shtesën në organikë me një shofer të titullarit të institucionit.

5. Të miratojë ndryshimin e emertesës nga “ Pergjegjes Administrate” në “specialist i nivelit të lartë për administratën , sekretarinë dhe arkivën”.

6. Pagesa për ndryshimet në strukturën e NSHP do të kryhet sipas tabelës së mëposhtme.

1

Emertimi	Nr. i punonj esve	Kategoria	Paga e grupit	Shtesa per vjetërsi	Shtesa per pozicion	Kategori fikse
Pergjegje i D.Teknike	1	III.b	10050	2%	26712	
Specialist i lartë planifikim prokurim..	1	IV.a	10050	2%	13696	
Specialist i lartë për privatizimin	1	P.15				27143
Specialist i lartë për admin...arkiva	1	IV.a	10050	2%	13696	
Punetor Gjelberimi	1	P.16				18444
Shofer	1	P.16				21714

7. Efektet financiare do të përballohen nga fondi i planifikuar i pagave i llogaritur në buxhetin e NSHP për vitin 2007.

8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Personelit, Protokoll-Arkivës dhe Mbështetjes në Bashki dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit

Raimonda NASE

